

Vendim 40-27/2012

Bazuar në nenin 36 paragrafi 1.12 të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nenin 3 paragrafi 3.3 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimeve dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, në zbatim të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe me qëllim të shmangies së dukurisë së lëshimit të policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për mjetet motorike me regjistrim të huaj si dhe të ndalimit të dukurisë së daljes në qarkullim të mjeteve motorike të pa siguruara, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22 tetor 2012, mori vendim për të lëshuar këtë:

UDHËZIM

Për mënyrën e lëshimit të Policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për mjetet motorike që regjistrohen për herë të parë në Kosovë dhe ndalimin e shitjes së Policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për mjetet motorike me regjistrim të huaj

1. Të gjitha Kompanitë e Sigurimeve të licencuara nga BQK-ja për shitjen produktit sigurim i detyrueshëm nga autopërgjegjësia obligohen të veprojnë si në vijim:
 - a) Nuk duhet të lëshojnë në asnjë mënyrë polica të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për mjetet motorike me regjistrim të huaj, përveç sipas percaktimeve të nenit 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.
 - b) Polica e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për mjetet motorike që regjistrohen për herë të parë në Republikën e Kosovës, do të lëshohet vetëm pasi është siguruar (prezantuar) nga pronari i mjetit motorik ose i autorizuari i tij dokumentacioni origjinal i zhdoganimit (Dokumenti Unik Doganor-DUD) lëshuar nga Dogana e Kosovës dhe polica e sigurimit kufitar të autopërgjegjësive e vlefshme për territorin e Republikës së Kosovës.
 - c) Dokumenti origjinal i zhdoganimit (DUD) dhe polica e sigurimit kufitar që vërteton se mjeti motorik ka qenë i siguruar me sigurim kufitar deri në momentin e zhdoganimit, duhet të mbahen dhe ruhen në dosje të secilës policë të lëshuar.

2. Byroja Kosovare e Sigurimeve do ta kthej primin e sigurimit nga polica kufitare e autopërgjegjësish për ditët e mbetura nëse policembajtësi ka bërë kërkesë për kthimin e primit dhe pasi i ka prezantuar Byrosë policen e vlefshme të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.
3. Ky vendim është efektiv nga data e miratimit të tij.



Gani GËRGURI

Guvernator

Kopje: Kompanive të Sigurimeve
Byros Kosovare të Sigurimit
Departamentit të Mikëqyrjes së Sigurimeve
Departamentit të Licencimit dhe Rregullimit